

VENDIM
Nr. 577, datë 3.8.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I RRUGËS “MUJO ULQINAKU” (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS
“JAKOV MILE””, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës “Mujo Ulqinaku” (seg. i dytë) dhe rrugës “Jakov Mile””, Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 006 581 (katër milionë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 006 581 (katër milionë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Fier.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojë të gjitha transak-sionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe Bashkia Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTI "RIKONSTRUKSION I RRUGËS "MUJO ULQINAKU" (SEG. I DYTË) DHE I RRUGËS "JAKOV MILE"", FIER

Nr .	Emër, mbiemër	Zona Kadas- trale	Nr. i pasu- risë	Sip. e përgj. e truallit (m²)	Sip. e preku r e trualli t (m²)	Çmimi për truallin (lekë/ m²)	Vlera e truallit (lekë)	Sip. totale e ndërtesës me certifikat ë (m²)	Sip. e prekur ndërtesës (m²)	Amorti- zimi (%)	Vlera e ndërte- sës me preven- tiv (lekë)	Vlera e përgjith . (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Sokol Nazmi Mecaj	8533	7/996	177.0	177.0	11,026	1,951,6 02	48	48	30%	1,007,50 9	2,959,11 1	Konfirmim nga ZVPP-ja
2	Llaçi Thanas Bocova dhe 4 bashkëpronarë	8533	7/916	410.0	10.0	11,026	110,26 0	-	-	-	-	110,260	Konfirmim nga ZVPP-ja
3	Halime Shateri e të tjerë	8533	7/257	85.0	85.0	11,026	937,21 0	-	-	-	-	937,210	Konfirmim nga ZVPP-ja
										Vlera totale		4,006,58 1	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".